REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 205/17
Datë/Datum. 03.07.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Kuvendi i Komunës Dragash, Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **621-17-2649-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Ujësjellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjecar)**

ANKESË

Puna SH.P.K.
(Emri i Operatorit Ekonomik)

Rr. Tahir Sinani, Blloku C2/B
(Adresa)

Prizren
(Vendi)

40000
(Kodi postar)

-
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Vahidin Halili
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[redacted]
(Adresa elektronike)

03 Korrik 2017
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Ndërmarrja ndërtimore projektuese PUNA Sh.p.k. PRIZREN

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

Kërkesa për Rishqyrtim, në përputhje me Nenin 108/A, është paraqitur edhe në formë me shkrim dhe protokoluar dhe në formë elektronike me datë 20 Qershor 2017.

Autoriteti Kontraktues ka refuzuar të përgjigjet tërësisht në Kërkesën për Rishqyrtim duke e injoruar të njejtën. Kjo duke bërë shkelje të Nenin 108/A në lidhje me zgjidhejn preliminare të pretendimeve ankimore.

Rrjedhimisht, brenda afateve ligjore paraqitet kjo Ankesë pranë OSHP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Me anulimin pa bazë të tenderit të mëparshëm dhe inicimin e tenderit të ri për të njëjtën cështje, AK Komuna e Dragashit vepronë në kundërshtim me dispozitat e mëposhtme të LPP-së:

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), në cilësinë e organit administrativ të shkallës së dytë përmes Vendimeve PSH 263/16; PSH 334/16; PSH 423/16; dhe Vendimin PSH 50/17 e ka detyruar Komunën e Dragashit të nënshkruaj Kontratën me Puna ShPK si oferta e përgjegjshme me cmimin më të lirë, dhe i ka dënuar zyrtarët komunal për moszbatim të Vendimeve të plotfuqishme. Komuna e Dragashit me tenderin e ri i ri-tenderon të njejtat pozicione

Neni 108/A – Autoriteti Kontraktues në kundërshtim me obligimet e tij ligjore nuk shqyrton fare Kërkesën për Rishqyrtim.

Neni 8 Planifikimi i Prokurimit dhe Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur – Ky aktivitet Prokurimi është në kundërshtim me planifikimin e nevojave dhe Disponueshmërinë e mjeteve. Të njejtat punë, Faza III e punimeve tenderohet dy herë, fillimisht me tenderin e parë dhe tash me tenderin e dytë. Me tenderin e atakuar me këtë Ankesë, vecse është shtuar volumi i punëve, duke i përfshirë punët paraprake.

Kreu V Autorizimi për inicimin e një aktiviteti të prokurimit dhe nënshkrimin e kontratës Publike – Ky aktivitet i prokurimit duhet anuluar për shkak se është në kundërshtim me Vendimet e mëhershme, dhe paraqet tenderim të dyfishtë të të njejtave pozicione, duke dëmtuar rëndë buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit – Asnjë prej kushteve të parashikuara me Nenin 62 të LPP-së nuk janë plotësuar për të lejuar anulimin e tenderit paraprak dhe hapjen